



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. dhe 1.5., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, më datën 14.07.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Dep.	06/02	Nr. Prot.	1419/23
Dep.		Sr. Prot.	
Dep.		Prot. No.	
Nr. Faj.	03	Data	14-07-2023
Sr. Str.		Data	
M. Page		Data	

Mbyllet rasti me nr. APK-DPKI-06-255/23, për zyrtarin Halil Kukaj, ish Dekan në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të kërkesës nga jashtë, ka filluar procedurën e hetimit administrativ për shqyrtimin e konfliktit të interesit lidhur me pretendimet si në vijim:

Halil Kukaj, në cilësinë e Dekanit të Fakultetit Ekonomik, ka bërë propozimin për formimin e komisioneve për pranimin e studentëve të rinj në studimet bachelor për vitin akademik 2021/2022 në Fakultetin Ekonomik, drejtuar Senatit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, ndërsa ishte pjesë e komisionit për vlerësimin e testeve të provimit pranue, si dhe ka bërë propozim vendim drejtuar Senatit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren për formimin e komisioneve për pranimin e studentëve të rinj në studimet Master për vitin akademik 2021/2022, ku ishte Anëtar i komisionit për zbatimin e konkursit.

Ish zyrtari i lartë Halil Kukaj, me vendimet nr.01/178, 01/65, 01/182, 01/180 ka emëruar komisionet për mbrojtjen e punimit të diplomës për studimet Master. Në tri komisione ishte caktuar Kryetar ndërsa në një komision ishte caktuar Anëtar.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, e ka njoftuar zyrtarin Halil Kukaj, me shkresë njoftuese për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pastaj është organizuar një takim me zyrtarin në Agjenci, i cili është njoftuar për pretendimet e ngritura për konflikt interesi.

Agjencia ka kërkuar dhe pranuar dokumentacionin/ informacionet relevante nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton si në vijim;

Halil Kukaj, ishte zgjedhë Dekan i Fakultetit Ekonomik nga Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren me Vendimin nr.01-134 të datës 26.04.2018.

Në bazë të Rregullores nr.01-180 për Punën e Këshillit të Fakultetit, Dekani i Fakultetit Ekonomik është Kryesues i Këshillit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

Ish Dekani i Fakultetit Ekonomik gjatë ushtrimit të detyrës ishte i angazhuar edhe si mësimdhënës për lëndët që ishte punësuar para zgjedhjes në këtë pozitë udhëheqëse sipas Rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

Sipas nenit 58 të Rregullores nr.01/491 për Përcaktimin e Kritereve për Studimet Themelore, Dekani ose Prodekani e cakton Komisionin në bashkëpunim me shefat e programeve mësimore, si dhe Dekani i Fakultetit cakton komisionin për mbrojtjen e temës së Diplomës për studimet Master, në mbështetje të nenit 23 të Rregullores nr. 01/494 për Caktimin e Kritereve të Studimeve Master.

Ish zyrtari i lartë Kukaj, përmes shkresës zyrtare 02-287 ka propozuar për Senatin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, formimin e komisioneve për arsye se Këshilli i Fakultetit nuk kishte kuorum për mbajtjen e mbledhjeve. Mos formimi i komisionit do të pamundësonte regjistrimin e gjeneratës së re të studentëve.

Propozimi për formimin e komisioneve për pranimin e studentëve të rinj në studimet themelore bachelor dhe master në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren nuk paraqet konflikt interesi sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kjo për faktin se nuk është vërtetuar se veprimet e Halil Kurtaj, kishin interes privat dhe as përfitimi financiar, lidhur me pjesëmarrjen e tij në ato komisione.

Pjesëmarrja e Halil Kukaj, në Vendimmarrje për formimin e Komisioneve për mbrojtjen e temave të Diplomës, i cili në tri komisione ishte caktuar Kryetar dhe një Anëtar, nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit sipas Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit sepse nuk është vërtetuar shfrytëzimi i funksionit publik për interesa private të ish zyrtarit të lartë.


Halil Kukaj, në përputhshmëri me Rregullativën e brendshme të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, ka bërë emërimin e komisioneve për mbrojtjen e temave të diplomës, njëkohësisht gjatë ushtrimit të detyrës së Dekanit i njëjti ishte i angazhuar edhe si mësimdhënës për lëndët cilat edhe ishte i punësuar.



Andaj, nga sa u tha më lartë, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Buleshka
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

